



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK dënon dhunën e policisë të ushtruar sot ndaj protestuesve paqësor

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dënon dhunën e policisë të ushtruar sot ndaj protestuesve paqësor, në protestën gjithëpopullore me moton “Jabllanoviç jashtë – Trepça është e jona.”

E drejta për të protestuar në mënyrë paqësore është e drejtë themelore e çdo qytetari në një shtet demokratik.

Mirëpo, ajo çka i parapriu protestës përfshirë arrestimet e ndryshme, ndalimet e udhëtimit të autobusëve me protestues që vinin nga qendra të ndryshme të Kosovës, vendosja e barrikadës së policisë rreth qeverisë, konfiskimi i mjeteve të zërimit të protestës etj., përbëjnë veprime jo-demokratike, që më së shumti i shërbyen acarimit të protestuesve, ende pa nisur protesta.

Këto veprime, si dhe hedhja e gazit lotës-jellës në protestën që nisi si protestë paqësore, provokuan eskalimin e situatës dhe gjithë dhunën që ndodhi më pas.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org